



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA  
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. \_\_\_\_\_

579/2016  
10. 09. 2016

Date: 29.09.2016

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016, miratoi këtë:

### MENDIM JURIDIK

Kompetente në pikëpamje lëndore për zgjidhjen e lëndëve kur është fjala për veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328. të KPK dhe veprën penale armëmbajtja pa leje të parashikuar nga neni 374. i KPK, është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore.

Procedurat penale duhet të përfundojnë në po atë departament në të cilin ato tashmë kanë filluar.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjiilan, me parashtrësën e datës 18.01.2016, ka kërkuar nga kjo Gjykatë të japë mendim juridik lidhur me kompetencën lëndore kur është fjala për veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328. par.1 të ish KPK-ës, dhe veprën penale armëmbajtja pa leje të parashikuar nga neni 374. të KPK-ës (në aplikim).

Dilemat me të cilat është ballafaquar paraqitësi i kërkesës për mendim juridik rrjedhin nga dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe Ligjit për Gjykatat.

*Përderisa neni 22.1.75. të KPPK-ës,* parashihet se vepra penale armëmbajtje pa leje e parashikuar nga neni 374. të KPK është krim i rëndë, në dispozitën e nenit 15.1.21. të Ligjit Për Gjykatat, kjo veprë penale nuk përmendet shprehimisht, por thuhet se Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore gjykon për *(në vijim janë numëruar veprat konkrete penale)* “çfarëdo krimi tjetër të dënueshëm me dhjetë (10) ose më shumë vite burgim”.

~~*Më datën 15.06.2015-ka hyrë në fuqi Ligji për Gjykatat, me të cilin është ndryshuar Ligji për Gjykatat (nr.03/L-199), datë. 01.01.2013.*~~

*Me dispozitën e nenit 5 të këtij ligji,* me të cilin është riformuluar *(ndryshuar)* neni 15.1.21 i ligjit paraparak, thuhet: “ *Se Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës themelore gjykon për çfarëdo krimi tjetër të dënueshëm me mbi dhjetë (10) vite burgim*”.

*Në situatën e tanishme,* kemi një rregullim divergjent të çështjeve që kanë të bëjnë me armëmbajtjen pa leje përkatësish me neni 374 të KPK-s , ngase derisa neni 22.pika 1.75 KPPK-s, këtë veprë penale e konsideron krim të rëndë, Ligji Për Gjykatat, këtë veprë penale nuk e përfshinë fare në katalogun e krimeve të rënda, ndërsa nuk është në natyrën e KPP-s që të përcaktoi kompetencën lëndore dhe territoriale, kjo kompetencë rregullohet me Ligjin Për Gjykatat.

*Me këtë ndryshim* të ligjit janë evituar dilemat që kishte krijuar në praktikën gjyqësore norma e mëhershme. Prandaj veprat penale të parashikuara nga neni 328. i KPK *(të vjetër)* dhe 374. të KPK *(tani në aplikim)* nuk janë krime të rënda, dhe do të procedohen në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, sepse për asnjërën prej tyre nuk sanksionohet dënimi me mbi dhjetë (10) vjet burgim.

*Për të mos lënë dilemë,* Departamenti për krime të rënda, ka kompetencë lëndore t'i gjykoi të gjitha veprat penale, për të cilat mund të shqiptohen mbi dhjetë(10) vjet burgim, si dhe veprat tjera penale që i janë lënë në kompetencë ekskluzive këtij departamenti, me Ligjin Për Gjykata *(pavarësisht se KPPK, mund të parashihet ndryshë).*

Si do që të jetë, çështjet që kanë filluar të procedohen nëpër departamentet përkatëse, duhet të përfundojnë në këto departamente.

*(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme , i mbajtur më 29.09.2016 )*